



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, me 17.04.2020 në ora 10 në Gjimnazin “Ulpiana” në Lipjan.

Në mbledhje prezentuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Mehmetali Krasniqi, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Fadil Sopa, anëtar
5. Hyra Bytyçi, anëtare
6. Ramadush Tasholli, anëtar
7. Naim Jahiri, anëtar
8. Naim Stullca, anëtar
9. Majlinda Sylejmani, anëtare
10. Fatime Krasniqi, anëtare
11. Arif Miftari, anëtar
12. Xhyzide Rrustemi, anëtare
13. Lulzim Rrustemi, anëtar
14. Ramiz Qeriqi, anëtar
15. Argjent Tasholli, anëtar
16. Nazmi Krasniqi, anëtar
17. Lumturije Bytyqi-Hasani
18. Egzona Bytyqi, anëtare
19. Shkelzen Bislimi, anëtar
20. Albulena Kelmendi, anëtare
21. Alban Salihu, anëtar
22. Afrim Miftari, anëtar
23. Hajdin Bytyqi, anëtar
24. Safete Amerllahu, anëtare
25. Bashkim Budakova, anëtar
26. Ukë Kryeziu, anëtar
27. Ganimete Qeriqi, anëtare
28. Manush Shamolli, anëtar
29. Egzona Fazliu, anëtare
30. Arben Salihu, anëtar
31. Fehmi Rexhepi, anëtar

Të tjerë prezent:

Imri Ahmeti, kryetar i Komunës
Fauz Xhemajli, nënkryetar i Komunës
Avni Olluri, drejtor i DA
Bekim Shabani, drejtor i DEZH-së
Latif Ramadani, drejtor i DBF-së
Emina Rexhiq, drejtoreshë e DPU
Rasim Hasani, drejtor i DSHP
Imer Rustemi, drejtor i DI,
Anila Reçica, drejtoreshë e DRKS
Merita Bytyqi, drejtoreshë DSHMS
Besart Troshupa, zyra e informimit
Bestar Ibrahim, zyrtar i teknologjisë
Përfaqësues të mediave dhe numër i konsiderueshëm i qytetarëve

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Rrahim Krasniqi**.

Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, tha se me kërkesë të Kryetarit të Komunës kam thirrë mbledhje të jashtzakonshme për shkak të situatës në të cilën gjindemi.

Uroj që sa më shpejtë ta kalojmë këtë situatë dhe t'i kthehemi normalitetit po ashtu të infektuarëve ju uroj shërim sa më të shpejtë.

Pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Propozim vendim për ndarjen e mjeteve finaciare për ndihma të familjeve në nevojë dhe nevojat tjera të menaxhimit të situatës emergjente nga covid 19
2. Propozim vendim për lirim nga pagesa e taksave dhe qirasë komunale.
3. Propozim vendim për lirim nga pagesa e tarifave në institucionet për edukim dhe arsimim parashkollor publik.
4. Propozim vendim për ndarjen e mjeteve financiare për klubet sportive.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, pyeti se a ka dikush vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës.

Meqë vërejtje nuk pati rreth rendit të ditës, Kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit konstatoi se me të gjitha votat prezente, kaloi rendi i ditës.

Lulzim Rustemi, uroj që sa më shpejtë ta kalojmë këtë pandemi, është mirë kryetari në pika të shkurta të na njoftoj mbi gjendjen në Komunën e Lipjanit pas pandemisë dhe masat të cilat I ka ndër marrë komuna.

Imri Ahmeti, Kryetari i Komunës, tha se në Lipjan kemi pasë dy raste njëri nga Janjeva i cili tani më është i shëruar dhe tjetri në fshatin Krojmir, rast I vetizoluar. Po ashtu kemi dhe një familje nga Lipjani me prejardhje nga Pjetërshtica e Shtimes.

Ne e kemi formuar edhe Shtabin Emergjent, po ashtu siq e dini edhe ju në seancën urgjentet ne kemi nda një shumë të mjeteve nga mallrat dhe shërbimet për t'ju dalur në ndihmë familjeve

në nevojë. Ku ju falemnderoj të gjithëve për kontributin tuaj si anëtar të kuvendit me votën tuaj online që keni votuar. Po ashtu e falemnderoj edhe Shtabin emergjent prej 2 personave në krye me nënkrytarin Fauz Xhemajli të cilët nuk janë ndalur duke punuar për të cilët nuk ka qenë aspak e lehtë sepse të ngarkosh e të shkarkosh rreth 87 ton miell nuk është punë e lehtë. Kanë ndihmu edhe organizatat tjera siç janë Viva Fresh, Buqaj, Elkosi, BIK-Lipjan, Kryqi I Kuq, po ashtu edhe Halil Kastrati Elvis Naci, etj ku deri më tani janë ndihmuar 2051 familje përmes Komunës dhe Organizatave të tjera. Këtë listë e kanë bërë këshillat e fshatrave çendra për punë sociale së bashku me shtabin emergjent.

Nëse dikush i din vetëm 2 familje që janë refuzu në baza partiake le t'ua thotë emrin, ju ftoj të gjithëve që të na korigjoni por të na korigjoni drejt.

Unë kam refuzuar të marrë pjesë në ndarjen e ndihmave në teren me përjashtim të Janjevës e cila ka qenë e karantinuar dhe dje që e kam pritë hoxhë Halil Kastratin. Po ashtu i kam lut edhe këshilltarët Komunal po ashtu edhe zyrtarët Komunal që mos të bëjnë foto gjatë shpërndarjes së ndihmave nëpër familje.

Për fund ju kisha lut që së bashku t'i eliminojmë të metat dhe defektet.

Në këtë vit nuk do kemi realizim të hyrave qysh e kemi pritë.

I

Propozim vendim për ndarjen e mjeteve finaciare për ndihma të familjeve në nevojë dhe nevojat tjera të menaxhimit të situatës emergjente nga covid 19

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Latif Ramadanit, drejtor i DBF, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Shkelzen Bislimi, të sëmuarve ju uroj shërim sa më të shpejtë, ne si grup parlamentar i VV e mbështesim këtë propozim vendim vetm kërkojmë që ndihmat që ndahen të shkojnë aty ku duhet.

Lulzim Rustemi, edhe ne si grup parlamentar e përkrahim këtë propozim dhe propozimet tjera, kemi propozim që të shkon në 150000 euro pasi që ne duhet të kujdesemi që asnjë familje mos të lojmë keq po ashtu mos të shpenzojmë buxhet kot, pasi që nuk i dihet kohës nuk i dihet pandemisë. Ne duhet të punojmë bashkarisht që asnjë familje mos të ndihet e rezikuar. Ne propozojmë këtë shumë për arsye që të mos mbetet asnjë familje sociale e as një familje e pa punësuar pa përfshi. Po ashtu kërkoj nga Shtabi emergjent që kriteret të jenë të drejta ndihmat të ndahen drejtë dhe mos të mbetet asnjë familje pa përfshi. Ne e falemnderojmë shtabin emergjent për punën që po e bënë dhe ne jemi të gatshëm të ndihmojmë në çdo rast që kërkohet ëfardo kohe që është e mundshme.

Imri Ahmeti, është një vendim i qeverisë që e specifikon mjetet të cilat mundem me u shfrytëzuar, në këtë vendim shënon që deri në 5% lejohet nga ky program të tërhiqen mjete nga investimet kapitale. Ne do t'i rrisim këto mjete nga mallrat dhe shërbimet por duke mos i dëmtu projektet në teren. Ne do t'i përfshijmë të gjitha kategoritë siç janë kategoritë e dala nga lufta femijët me autizëm, nënat vet ushqyese, klubet e sportit.

Hyra Bytyçi, seanca e sotme e jashtëzakonshme ka për qëllim që të aprovohet sa më shpejt pakoja emergjente, duke u bazuar në situatën emergjente të përballjes me pandemin Covid 19 dhe për t'i dalur në ndihmë sa më shpejt qytetarëve të komunës sonë.

Është shqetësuese fakti se deri më sot në komunën tonë janë paraqitur 6 raste me Covid 19 dhe mbi 400 në tërë Kosovën.

Sot më shumë se kurrë është momenti që t'i ofrojmë mbështetje njëri tjetrit, për përballjen me Covid 19.

Ne si grup parlamentar i LDK- së jemi këtu për ta mbështetur pakon emergjente të cilin e ka propozuar kryetari i komunës Imri Ahmeti së bashku me stafin e tij i cili çdo herë ka treguar gatishmëri dhe vullnet për t'ju dalur në ndihmë qytetarëve.

Ne si grup parlamentar i LDK- së urojmë që të jenë rastet e fundit jo vetëm në Kosovë por në të gjithë globin. Po ashtu apelojmë te qytetarët që sa më shumë t'ju përmbahen rekomandimeve të Ministrisë së Shëndetësisë. Po ashtu kërkojmë nga organet e sigurisë që t'i shtojnë masat e sigurisë, për ta parandaluar përhapjen e virusit.

Afrim Miftari, edhe ne si grup parlamentar e përkrahim këtë propozim vendim dhe automatikisht të bëhet i plotfuqishëm pasi që dihet që jemi në situatë emergjente. Në fund në bazë të kushteve që na janë ofruar këtu Administrata e Kuvendit të dalim së bashku me një apel që të respektohen rekomandimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik që qytetarët të qëndrojnë sa më shumë në shtëpitë e tyre. Po ashtu ne edhe propozimet tjera i përkrahim.

Ganimete Qeriqi, unë punoj në institucionin e Shëndetësisë që është një urë që ditën ndërtohet e natën rrënohet. Institucioni ku unë punoj nuk janë dezinfektuar, asnjë kritikë nuk e kam për drejtoreshën Merita Bytyqi, pasi që e ka marrë shëndetësinë në një kohë ku gripi Covid 19 edhe shtete globale i ka qit prej sistemit e le më Kosova që ka një sistem të shkatëruar. Tek tani shëndetësia është bërë zëri themelor në nivel vendi,

Një pyetje e kam a kena me harru Covidin? Mua deri me tani askush nuk ka ardhë të me inspektoj se ku i pastroj duart?

Ka ardhë koha me u bërë bashkë të gjithë me vazhdu këtë trend me i përmirësu shërbimet.

Imri Ahmeti kryetari i komunës, e para ju kisha lut që diskutojmë rreth rendit të ditës pasi që është seancë e jashtzakoshme për nevojat të menaxhimit të Covid 19.

Shëndetësia e Lipjanit nuk mund të dalloj nga ajo e nivelit shtetëror edhe oborri i shtëpisë së shëndetit është dezinfektuar, përkundrazi e kemi ble aparturën në QKM-f për dezinfektim ku ju vet e përdori atë aparaturë. Ne e dijmë para një kohe nuk ka lanë njeri pa e fy personelin tonë shëndetësor në Lipjan për shkak të një video tash dalim i bëjme herojnë, të nejtij punëtorë janë. Këto punëtor janë vëllëzrit dhe motrat e këtij vendi.

Ganimete Qeriqi, unë nuk thash që nuk është duke u menaxhu por mos e nda filli i këtij menaxhimi.

Daut Azemi, ne duhet vet t'i pastrojmë duart nuk ka nevojë askush të na inspektoj.

Majlinda Sylejmani, të infektuarve me covid 19 ju uroj shërim sa më të shpejtë, deshta me i përgëzu Kryetarin dhe Shtabin emergjent për punën e mirë që e kanë bërë gjatë kësaj situatë në të cilën po kalojmë. Na sot jemi mbledhë për ta votuar një pako emergjente e cila është një ndihmë dhe lehtësim i madh financiar për qytetarët dhe bizneset e komunës së Lipjanit. Unë kisha kërku që ne si kuvend t'i japim një duartrokitje të gjithë personelit shëndetësor për punën dhe angazhimin e tyre.

Daut Azemi, nëse jeni për një duartrokitje për stafin mjekësor atëherë ua japim një duartrokitje.

Lumturije Bytyqi-Hasani, ne kemi përpara një vendim i cili është në kohën e duhur, i cili do të lehtësoj sa do pak kushtet familjarve të cilët preken nga kjo gjendje.

Unë e kam një sygjërim për Shtabin që të jenë edhe nënat vetushqyese përfituese.

Ramiz Qeriqi, kisha dëshirë me ditë se cfarë kriterë keni dhe ku bazoheni në rastet të cilat i ndihmoni, pasi që sot janë bërë të barabartë sikur rastet sociale sikur kta tjerë pasi që kemi raste që deri më tani kanë punë tani janë të pa punë. Unë e di që ju si Shtab nuk e keni lehtë pasi që gjendja ka ndryshu. Është mirë të merremi me bujqit së paku të ju ndihmohet me pleh artificial. Duhet të jemi të gjithë së bashku pa parti që ta kalojmë sa më shpejtë këtë pandemi.

Bashkim Budakova, edhe unë uroj që sa më shpejtë ta kalojmë këtë situatë, ne si grup parlamentar i AAK-së i përkrahim të gjitha pikat e propozuara për sot.

Përveq familjeve me nevojat sociale kemi edhe familje tjera që nuk e gëzojnë këtë të drejtë ku buxheti i tyre familjar është zvogluar nga kjo pandemi. Ne jemi të gatshëm të ndihmojmë, dhe urojmë sa më shpejtë që t'i kthehemi normalitetit.

Fauz Xhemajli, burimet nga të cilat ne si Shtab kemi pranuar kërkesat janë Qendra për Punë Sociale, Kryqi i Kuq, nga këshillat e fshatrave, ku ne i kemi thirrë Bashkësinë Islame, Kryetarët e fshatrave dhe shoqatat e familjeve të Dëshmorëve të Invalidëve të Luftës.

Do të përfshihen në këtë ndihma të gjitha kategoritë të cilat kanë nevojë.

Ukë Kryeziu,edhe unë ju uroj shërim sa më të shpejt të shëruarve por i përgëzoj edhe Shtabin për punën e palodhshme të cilën po e bëjnë,kam një propozim që të përfshihen edhe bujqit pasi që jemi në fazën e fundit për mbjelle pranverore dhe është mometi i fundit qe bujqve duhet të ju ndihmohet.

Ramiz Qeriqi, sipas meje kryetarët e fshatrave mujnë me dhanë një kontribut pasi që ata e dinë kush nuk është duke punuar,në qytet është pak më vështirë.Për momentin shtresa më e rrezikuar është shtresa e cila kanë qenë duke punuar e tani nuk janë duke punuar askund,sepse shoqatat kanë një penzion të cilin vazhdojnë ta marrin.Unë jam i gatshëm me veturë time nëse është nevoja ndonjëherë të ju ndihmojë.

Fehmi Rexhepi,dola ta falendëroj grupin emergjent për punën që po e bëjnë në teren në ndarje të ndihmave e në veqanti të komunitetit tonë,kisha kërku që çdo ndarje e cila po bëhet të bëhet nga shtabi emergjent pasi qe këta po bëjnë një punë të mrekullueshme. Ka nevojë edhe disa familje të komunitetit të ndihmohen.

Lumturie Bytyqi-Hasani,propozoj që shtabi të plasoj një platformë elektronike ku qytetarët dretpërdrejtë do të bënin kërkesë që të jenë përfitues të asaj ndihme.

Lulzim Rrustemi,ne presim që të ketë edhe një seancë tjetër e të merret me sektorin e bujqësisë dhe ndërtimtarisë që janë dy sektor të cilët kanë mbetur keq,po ashtu kërkojmë nga kryetarët e fshatrave që të bashkëpunojnë me këshillat e fshtrave që të mos mbetet asnjë familje pa u përfshi.

Imri Ahmeti,ju falenderoj të gjithëve për kontributin e dhënë.Pajtohna që të ketë një platformë online për aplikim.Më mirë se kryetarët e këshillit të fshatrave nuk e dinë gjendjen në vendet e tyre. Kërkoj që asnjë familje të mos mbetet pa u ndihmuar të paraqiten ose te kshillat e fshatrave ose te Shtabi emergjent,dhe po e përserisë edhe një herë që puntorët e administratës nuk e kanë të lehtë me ngarku e shkarku mall sepse kanë referate tjera,po vullneti i tyre nuk ka mungu për me kryer këtë punë.

Uroj qe personat e infektuar te sherohen sa me shpejte dhe mos te kemi raste te tjera,Zoti na ndihmoftë të gjithëve ta kalojme këtë epidemi.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit konstatoi se me 31 votat për, aprovoi këtë:

Propozim vendim për ndarjen e mjeteve finaciare për ndihma familjeve në nevojë dhe nevojat tjera të menaxhimit të situatës emergjente nga covid 19

II

Propozim vendim për lirim nga pagesa e taksave dhe qirasë komunale.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën Rasim Hasanit , drejtor i DSHP, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lumturije Bytyqi-Hasani,ne e përkrahim këtë propozim vendim,kam një pyetje a do të lirohen gjatë tërë vitit pasi që e dijmë që pandemia është shpallë në mars,a do të filloj lirimi prej 1 janarit 2020 apo prej kur?

Ramiz Qeriqi, e kam një kërkesë që familjeve që janë në banesa sociale të ju shtyhet pagesa për këtë vit pasi që nuk kanë mundësi t'i paguajnë.

Nehat Terpeza,ne si grup parlamentar i LDK-së e kemi shqyrtu këtë propozim vendim për lirim nga pagesa e taksave dhe qirasë komunale

Imri Ahmeti,në seancat e radhës do të përfshihet edhe qështja e banimit social,ndërsa kjo vlen prej sotit për tërë vitin 2020.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 26 votat për, aprovoi këtë:

III

Propozim vendim për lirim nga pagesa e tarifave në institucionet për edukim dhe arsimim parashkollor publik.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën Elmaze Behluli , drejtoreshë e DKA, e cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Megjë diskutime rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 29 votat për, aprovoi këtë:

IV

Propozim vendim për ndarjen e mjeteve financiare për klubet sportive

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën Anila Reqica-Llugiqi , drejtoreshë e DKRS, e cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Ramiz Qeriqi,kërkoj që në këtë të përfshihen të gjitha klubet sidomos KF Lipjani.

Lulzim Rustemi,ne si grup parlamentar e kemi shqyrtu këtë propozim vendim dhe e mbështesim. Pajtohem me Luanin që të gjitha klubet të përfshihen vetëm në bazë ligjore.

Eshtë mirë që me na ardhë edhe rregullorja e bursave për studentë ndoshta do të kishim dhënë kontribut edhe ne.

Imri Ahmeti, do të ndihmohen të gjitha klubet. Regulloren për bursa ka qenë në debat publik,po nëse kryesuesi mundet përmes menyrës elektronike ne jemi të gatshëm me pru ktu ose edhe në mënyrë elektronike.

Megjë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim vendimin dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me të gjitha votat për, aprovoi këtë:

Mbledhja përfundoi në ora 12,⁰⁰

Ekstraktin e hartoi
Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi